



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

Nr. 2330

Data: 04/03/21

AKT-MIRATIMI

ORGAN I MIRATUAR

PËR VLERËSIM KONFORMITETI TË
PRODUKTEVE/PAJISJEVE/INSTALIMEVE NËN PRESION DHE CERTIFIKIM TË
PERSONELIT

Mbështetur në Kreun V të ligjit Nr. 10 489, datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", i ndryshuar, Urdhrin e Ministrit Nr. 53 datë 05.10.2017 "Për miratimin e rregullores "Për procedurat e miratimit dhe mbikëqyrjes së organeve evropiane të notifikuara dhe organeve të miratuara të vlerësimit të konformitetit", si edhe në Çertifikatat e Akreditimit me Nr. **TI 020** dhe **CN 008** datë 22.04.2020.

MIRATOJ:

Subjektin:	"ECIT" sh.p.k.
Me Administrator:	Xhevit RESULAJ
Me Drejtues Teknik:	Xhevit RESULAJ
Adresa e subjektit:	Rruga "Medar Shtylla". Pall. nr.30. Ap. Nr. 27.Kati 4. Tirane,
Tel.:	-
Cel.:	069 20 60 245
E-mail:	ecitshpk@gmail.com

Të ushtrojë veprimtarinë si «Organ i Miratuar i Vlerësimit të Konformitetit (OMVK)» dhe «Organizëm i Certifikimit të Personave që përdorin Pajisje dhe Instalime nën Presion»:

Tipi i trupës së inspektimit:	Tipi A
Fusha e Inspektimit:	1. Inspektimi i rezervuarëve të GLN-së më të vegjël ose të barabartë me 13m³ mbi tokë. 2. Inspektimi i rezervuarëve të GLN-së me kapacitet më të madh se 13 m³, mbi tokë. 3. Tubacione nën presion. Aksesorët e sigurisë dhe aksesorët nën presion. 4. Pajisjet nën presion me vatra zjarri. Kaldajat e avullit dhe të ujit të nxehtë. 5. Çisternat automobilistike të transportit të mallrave të rrezikshëm. Klasa 2: Gaze të ngjeshur komprimuar, të lëngëzuar dhe të ngjeshur nën presion. Klasa 3: Lëngje të djegshme. 6. Inspektimi i rezervuarëve mbitokësor të hidrokarbureve të lëngët.

	7. Vlerësim konformiteti të projekteve teknike dhe teknologjike për produktet/pajisjet/instalimet, 8. Lëshim “Vërtetimi Teknik” për subjektet që kryejnë aktivitete në fushën e përpunimit, transportit dhe tregtimit të gazit, naftës dhe nënprodukteve të tyre. 9. Certifikim Personeli për: • Personat që përdorin rezervuarë GLN mbi dhe nën tokë me vëllim nën e mbi 13 m³, • Personat që përdorin qendrat e rimbushjes dhe depozitimit të bombulave, • Personat që përdorin kaldajat e avullit dhe ujit të nxehtë, • Personat që përdorin enë nën presion të pajisjeve teknologjike dhe rezervuarë ajri, • Personat që përdorin impiantet e shkarkimit dhe transvazimit të cisternave automobilistike të mallrave të klasës 2.
Rregullat teknike/standardet e sigurisë së produktit/pajisjes/instalimit të vënë në shërbim:	1. Ligji nr. 32/16, datë 24.03.2016 “Për garantimin e sigurisë të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”. 2. Vendimi i këshillit të ministrave Nr. 1062, datë 23.12.2015, “Për pajisjet dhe bashkësitë nën presion dhe përcaktimin e standardeve të harmonizuara” (aneksi V). 3. VKM Nr. 430, datë 26.06.2019 Për “Miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve të transportueshme nën presion 4. VKM nr, 491, date 19.07.2017 “Për përcaktimin e rregullave, të kushteve teknike dhe normave të mirëmbajtjes së instalimeve nën presion, që shërbejnë për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” 5. Standardi S SH EN 12817:2010 “Pajisje dhe aksesoret për GLN. Inspektimi dhe rikualifikimi i rezervuarëve të gazit të lëngshëm të naftës (GLN) më të vegjël ose të barabartë me 13 m³”. 6. Standardi S SH EN 12819:2009 “Pajisje dhe aksesoret për GLN. Inspektimi dhe rikualifikimi i rezervuarëve të gazit të lëngshëm të naftës (GLN) me kapacitet më të madh se 13 m³”. 7. Standardi S SH EN 13175:2014 “Specifikimi dhe provat për ventilët dhe pajisjet e rezervuarëve të Gazit të lëngëzuar të Naftës (GLN). 8. S SH EN 12972-2015 “Cisternat për transportimin e mallrave të rrezikshme - Provat, inspektimi dhe marktimi i cisternave metalike”. 9. Ligji nr. 9272, datë 16.09.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen Evropiane për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR) dhe protokollin e nënshkrimit.”

	10. Metode jo standarde - "Rregullore e shfrytëzimit të kaldajave me avull" e vitit 1984. 11. Metode jo standarde - "Rregullore e sigurimit teknik për kaldajat e avullit dhe ujit të nxehtë", nëntor 1988. 12. SSH EN ISO/IEC 17024:2012 "Vlerësimi i konformitetit – Kërkesa të përgjithshme për trupa që kryejnë certifikim personeli". 13. SSHEN13458-3, Enët Kriogjenike-Enët statike të termoizoluara në vakum, kërkesa të shfrytëzimit.
Periodha e vlefshmërisë:	Për fushat 1-8, deri më 21.02.2025, dhe; Për fushën sipas përcaktimit të pikës 9, deri më 21.04.2024
Teritori i ushtrimit të veprimtarisë:	Në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
Personi përgjegjës firmosës:	Xhevit Resulaj
Nr. Telefoni:	069 20 60 245
E-mail:	ecitshpk@gmail.com
OMVK regjistrohet me Nr. Identifikimi:	OMI 0 0 7

"Organi i Miratuar" i vlerësimit të konformitetit detyrohet të plotësojë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij kërkesat dhe kushtet e veçanta sa më poshtë:

1. Është përgjegjës për veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit të instalimeve/pajisjeve nën presion dhe Certifikimit të Personave që përdorin këto pajisje dhe instalime, të kryer sipas përcaktimit në aktin e miratimit dhe çdo veprimtari tjetër të kryer, përfshirë veprimtaritë nënkontraktuese.
2. Nuk duhet të përfshihet në veprimtaritë që mund të krijojnë konflikt interesi me pavarësinë/paanësinë e tij të gjykimit ose integritetin për aktivitetet e vlerësimit të konformitetit, për të cilat ai është miratuar;
3. Siguron se veprimtaritë e degëve ose nënkontraktorëve të tij nuk prekin/ndikojnë në konfidencialitetin, objektivitetin, paanësinë e veprimtarive të tij të vlerësimit të konformitetit;
4. I siguron Ministrin (strukturës administrative përgjegjëse), brenda 10 ditësh, kopje të certifikatave, raporteve të testeve dhe të vlerësimit të konformitetit, përfshirë dokumentet për to dhe informacionin për lëshimin, refuzimin ose tërheqjen e certifikatave për çdo subjekt;
5. Detyrohet të informojë Ministrin pa vonesë për çdo rast, në të cilin ky organ bëhet i paaftë të sigurojë përmbushjen e kushteve të vendosura për ushtrimin e miratimit të vlefshmërisë së konformitetit;
6. Informon brenda 5 ditësh Ministrin (strukturën administrative përgjegjëse) për çdo refuzim, kufizim, pezullim ose tërheqje certifikate;
7. Informon Ministrin për çdo kërkesë për informacion, të cilën ai ka marrë nga Inspektorati Shtetëror në vartësi të MEI-t për veprimtarinë e vlerësimit të konformitetit;
8. Detyrohet të mbajë regjistra të plotësuar rregullisht të të gjitha procedurave të vlerësimit të konformitetit, për të cilat ai është miratuar dhe të rezultateve të tyre për jo më pak se 10 vjet.
9. Me kërkesë të Ministrin përgjegjës detyrohet të marrë pjesë në testimet e kualifikimit ose krahasime të tjera të përcaktuara për organet e vlerësimit të konformitetit.
10. Në fund të çdo periudhe katërmujore, detyrohet të dërgojë Ministrin (strukturës administrative përgjegjëse) listën e inspektimeve ose certifikatave të lëshuara për periudhën në fjalë.
11. Organi i Miratuar detyrohet t'u krijojë akses të plote punonjësve të strukturës administrative

përgjegjëse, të pajisur me urdhër të Ministrit, që të evidentojnë të gjitha të dhënat për përmbushjen e kërkesave të vlerësimit të konformitetit dhe të hyjnë në vendet/ndërmarrjet ku janë kryer detyrat e përfshira në objektin e vlerësimit të konformitetit, siç është përcaktuar në miratimin e lëshuar.

Në rast të konstatimit të mos plotësimit të kërkesave dhe kushteve sipas pikave 2,3,4,5,6,8,9, 10,11, ose në rast se organi i miratuar nuk arrin të përmbushë më një apo disa kritere a kërkesa të përcaktuara në rregullat teknike përkatëse apo në rregullat për sigurinë e produktit/instalimit të vendosur në shërbim/në përdorim dhe kushtet e përcaktuara në Aktin e Miratimit, Struktura Administrative Përgjegjëse i propozon Ministrit pezullimin e Aktit të Miratimit deri në afatin e dhënë për plotësimin e tyre.

Nëse Organi i Miratuar dështon në plotësimin e kushteve dhe kërkesave sa më sipër brenda afatit të caktuar, Struktura Administrative Përgjegjëse përgatit dhe i paraqet për firmë Ministrit urdhërin për anulimin e Aktit të Miratimit dhe heqjen e emrit të OMVK nga regjistri i organeve të miratuara.

Datë: ____/____/2021

Ministri

Belinda Balluku